

**AKT THEMELIMI**  
**Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar**  
**“ Ancor Group “ SH.P.K**

Sot më datën 28.02.2024, Z. Lorval Petani i biri i Anesti i datëlindjes 05.09.1977 lindur dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike dhe zotësi për të vepruar, si dhe Znj. Jorida Mema e bija e Muharrem e datëlindjes 21.03.1980 lindur dhe banuese në Durrës, madhore me zotësi të plotë juridike dhe me zotësi për të vepruar. Vendosi të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “Ancor Group” SH.P.K si më poshtë vijon :

Neni 1

Personat fizik të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin Shqiptar, krijojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar ( SH.P.K ) me emërtimin “Ancor Group” SH.P.K

Ortakët e kësaj shoqërie janë Z. Lorval Petani dhe Znj. Jorida Mema.

Administratorët e kësaj shoqërie janë Z. Lorval Petani dhe Znj. Jorida Mema.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brënda dhe jashtë vëndit në çdo kohë që do të çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

Neni 2

Shoqëria “Ancor Group” SH.P.K, gëzon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Qendra e saj ndodhet në adresen: Durres Lagjja nr. 13, Rruga Pavarë sia, Hyrja 1, Pasuria Nr. 58/561

Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtjen : “Ancor Group” SH.P.K

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

Neni 4

Shoqëria “Ancor Group” SH.P.K do të ketë si objekt :

- Shërbim hotelerie, akomodim. Bar - Restorant, catering. Manaxhim të aktiviteve të hotelerisë për individë, grupe ose turistë. Ofrimi i shërbimeve turistike në kontekstin e ekspozitave, ngjarjeve turistike dhe konferenca, sallra lojrash, aktivitete argëtimi. Import - eksport. Transport në fushën e hoteleri - turizëm. Organizimi i ekskursioneve individuale dhe grupore, turne të qytetit në cdo mjet transporti. Pritje e klienteve në portet, aeroportet, stacionet e nisjes dhe mbërritjes së automjeteve të transportit.

Neni 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000 (Një qind mijë) Lekë.

## Neni 6

Fitimi neto që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie j'u përket 2 (dy) Ortakëve në masën e 50% secilit prej tyre.

## Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie, kjo shoqëri përgjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortakët e saj nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasuritë e tyre që nuk bëjnë pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

## Neni 8

Marrëdhëniet e punës në shoqëri ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.


## Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Themeluesët e shoqërisë pasi e lexuan me vëmendje akt themelimin e mësipërm dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e firmosin këtë akt themelimi pa vërejtje.

## ORTAKËT E SHOQËRISË

**LORVAL PETANI**



**JORIDA MEMA**

